



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelaria Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCE:	0 /897-2-2023
DATE:	26.05.2023
PËR/ZA/TO:	Feride Podvorica, zv.Drejtor i Departamentit Ligjor/ Ministria e Drejtësisë
CC:	Anna Kalanderi, zv Sekretare e Përgjithshme / Ministria e Drejtësisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Labinote Kashtanjeva, zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së / Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse <i>Projektligji për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve danezeve</i>

E nderuara znj. Podvorica,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për *Projektligji për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve danezeve*.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

26.05.2023

Departamenti Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë me datë 25 maj 2023, bazuar në Nenin 7, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafin 3 dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit *Projektligjit për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve dunezeve.*¹

1. SUBJEKTI

Opinion ligjor për përputhshmërinë e *Projektligjit për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve danezeve me acquis të BE-së.*

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për opinion ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente: drafti përfundimtar i Projektligjit (shqip, serbisht, anglisht),

¹ Emri i Projektligjit është transkriptuar ashti sic është pranuar në kërkesën fizike me nr. protokoli 897.

deklarata e Përputhshmërisë (shqip, serbisht, anglisht). Traktati në fjalë (shqip, serbisht, anglisht).

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 nën paragrafi 1.3, Neni 13 paragrafi 6, Neni 21 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, më datë 26 maj 2023 lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për opinionin ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në kopje elektronike dhe fizike më datën 24 maj 2023, me nr. reference 897.

5. HYRJE

Qëllimi i këtij *Projektligji* është ratifikimi i Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institutit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve danezeve.² Ky projektligj ka gjithsej 3 nene.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT AKTIT

Kapitulli 23 i *acquis* mbulon këto fusha: sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Politikat e Bashkimit Evropian në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas është i një rëndësie të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe një standard i lartë i gjykimeve nga gjykatat është i një rëndësie thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të fortë për të eliminuar ndikimet e jashtme mbi gjyqësorin dhe për të kushtuar burime të mjaftueshme financiare si dhe trajnime në fushën e gjyqësorit. Gjithashtu, garancitë ligjore për procedurat e gjyqësorit të drejtë duhet të jetë në vend. Njëkohësisht, nga Shtetet Anëtare kërkohet luftimi i korrupsionit në mënyrë efektive, pasi që kjo përbën një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike

² Neni 1 i Projektligjit

dhe sundimin e ligjit. Një kornizë solide ligjore dhe institucionale e besueshme është e nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin dhe pengimin e korrupsionit. Për më tepër, shtetet anëtare duhet të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore dhe të drejtave të qytetarëve të BE-së, siç garantohet me legjislacionin e BE-së dhe me Kartën e të Drejtave Themelore.

Dispozitat lidhur me transpozimin e acquis së BE-së në legjislacionin e Kosovës në fushën e drejtësisë rrjedhin nga MSA, si në vijim:

Neni 83

Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit

Sa i përket bashkëpunimit të tyre në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, Palët do t'i kushtojnë rëndësi të veçantë konsolidimit të sundimit të ligjit, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi dhe administrimit të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit në Kosovë dhe përmirësimit të efikasitetit të tij, zhvillimin e strukturave të përshtatshme për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët dhe organet tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për t'i përgatitur ata në mënyrë adekuate për bashkëpunim në çështjet civile, tregtare dhe penale, dhe për t'ju mundësuar atyre që në mënyrë efektive të parandalojnë, hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë krimin e organizuar, korrupsionin dhe terrorizmin.³

Dispozitat e *Projektligjit* në fjalë bëjnë ratifikimin e *Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve danezeve.*

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA MINISTRIA E LINJËS

I. Në aspektin përmbajtjesor dhe ligjor,

³ Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, Data e publikimit: 01.12.2015, Gazeta Zyrtare: 31/2015, e qasshme përmes: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11239>.

Duke ju referuar pikës 6 të ECIJ Opinioni i saj, fashio opinionin i *Projektligjit* bënë ratifikimin e Traktatit në fjalë dhe njëdhmësisht nuk aplikohen Tabelat e Përputhshmërisë së legjislacionit me *Acquis* të BE-së.

II. Në aspektin teknik,

Dokumentet shoqëruese janë plotësuar dhe dërguar sipas Manualit për Plotësimin e Tabelave të Përputhshmërisë dhe Deklaratës së Përputhshmërisë.⁴

8. OPINIONI PËR PËRPUTHSHMËRINË

Ky opinion për përputhshmërinë me *acquis* është bazuar në përmbajtjen e projekti aktit. Përgjegjësia e Divizionit të së Drejtës së BE-së vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa organi propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) atëherë kur Projekt akti ndërlihet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishtëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projektligjit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës.

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Fushëveprimi i *Projektligjit* bënë ratifikimin e *Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve danezeve.*

Me respekt,
Labinote Kashtanjeva

Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së
Divizioni për të Drejtën e BE-së
Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit

⁴ E qasshme në: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzuese-mbi-procesin-e-prafimit-ligjor>.